



# "STREHËZAT – NJË JETË E SIGURT PËR GRATË DHE FËMIJËT QË I MBIJETOJNË DHUNËS"



**Strehëzat janë shpesh vendi i parë ku siguria, dinjiteti dhe shpresa fillojnë të rindërtohen për gratë dhe fëmijët që i mbijetojnë dhunës.**

**Shelters are often the first place where safety, dignity, and hope begin to be rebuilt for women and children who survive violence.**

Më 5 dhjetor 2025, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), në bashkëpunim me Qendrën Psiko-Sociale "Vatra" dhe Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza, organizoi konferencën kombëtare "Strehëzat – Një jetë e sigurt për gratë dhe fëmijët që i mbijetojnë dhunës", me mbështetjen e Dukatis të Madh të Luksemburgut. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

On 5 December 2025, the Gender Alliance for Development Center (GADC), in cooperation with the Psycho-Social Center "Vatra" and the National Counseling Line for Women and Girls, organized the national conference "Shelters – A Safe Life for Women and Children Survivors of Violence", with the support of the Grand Duchy of Luxembourg. The event was held in the framework of the 16 Days of Activism against Gender-Based Violence.

Konferenca solli bashkë përfaqësues të institucioneve shtetërore, pushtetit vendor, Bashkimit Evropian, organizatave të shoqërisë civile dhe ofruesve të shërbimeve në vijën e parë, për të diskutuar mbi rolin jetik të strehëzave në garantimin e sigurisë, dinjitetit dhe rimëkëmbjes afatgjatë të grave dhe fëmijëve që i mbijetojnë dhunës.

The conference brought together representatives of state institutions, local government, the European Union, civil society organizations, and frontline service providers to discuss the vital role of shelters in ensuring safety, dignity, and the long-term recovery of women and children who survive violence.

Diskutimet u fokusuan në sfidat e financimit publik të qëndrueshëm për strehëzat, koston reale të ofrimit të shërbimeve cilësore, si dhe përgjegjësitë konkrete të institucioneve qendrore dhe vendore për të siguruar mbrojtje dhe fuqizim afatgjatë për të mbijetuarat. Panelistët theksuan se strehëzat nuk duhet të trajtohen si zgjidhje emergjente apo të përkohshme, por si shërbime thelbësore publike që kërkojnë buxhete të parashikueshme dhe politika të qëndrueshme.

Discussions focused on the challenges of sustainable public financing for shelters, the real cost of providing quality services, and the concrete responsibilities of central and local institutions in ensuring protection and long-term empowerment for survivors. Panelists emphasized that shelters should not be treated as emergency or temporary solutions, but as essential public services that require predictable budgets and sustainable policies.

Një mesazh i përbashkët i konferencës ishte se siguria nuk mjafton pa fuqizim. Mbështetja psikosociale, aksesimi i drejtësisë dhe integrimi socio-ekonomik janë elementë kyç për rimëkëmbjen reale të grave dhe fëmijëve që i mbijetojnë dhunës. Për këtë arsye, u nënvizua nevoja për bashkëpunim të fortë ndërinstytucional dhe partneritete të qëndrueshme mes shtetit dhe shoqërisë civile.

A shared message of the conference was that safety alone is not enough without empowerment. Psychosocial support, access to justice, and socio-economic integration are key elements for the genuine recovery of women and children who survive violence. For this reason, the need for strong inter-institutional cooperation and sustainable partnerships between the state and civil society was highlighted.

Konferenca ripohoi angazhimin e përbashkët për të ndërtuar një sistem mbështetjeje më të fortë, më të drejtë dhe të qëndrueshëm, ku asnjë grua apo fëmijë të mos mbetet pa një derë të hapur drejt sigurisë dhe dinjitetit.

The conference reaffirmed the shared commitment to building a stronger, fairer, and more sustainable support system, ensuring that no woman or child is left without an open door to safety and dignity.